Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të

shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “ERALD-G” Shpk, me Nuis K36306784K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ERALD-G” Shpk, me Nuis K36306784K, skualifikohet.

V- Operatori Ekonomik “G B Civil Engineering” Shpk, me Nuis L51825011V,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se: Operatori Ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike nën vlerën minimale të lejuar sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

KVO verën se operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertën ekonomike në përputhje me VKM-ne nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe vlera e ofertes ekonomike duhet të jetë jo më e vogël se vlera minimale, si dhe jo më e madhe se vlera maksimale e përcaktuar në përputhje me VKM-ne nr. 354, datë 11.05.2016, ku parashikohet se: “*Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik*”.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar sipas përcaktimeve të VKM-se nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshkrimet e kërkesave për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “G B Civil Engineering” Shpk, me Nuis L51825011V, për mos përmbushje të kritereve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “G B Civil Engineering” Shpk, me Nuis L51825011V, skualifikohet.

VI- Operatori Ekonomik “InfraKonsult” Shpk, me Nuis L21512022F,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se: OE nuk plotëson pikën 2.3.4 dhe 2.3.8, të kritereve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: **“2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtuës teknik) personeli si më poshtë:**

m. Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)
n. Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
o. Inxhinier Mjedisi	1 (nje)
p. Inxhinier Gjeodet	1 (nje)

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën

Nentor 2025 – Janar 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatëse.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.

-”2.3.8 Operatoret Ekonomike pjesemarres ne me shume se nje lot duhet te permbushin ne menyre kumulative te gjith kriteret e loteve te marra se bashku ne te kundert do te skualifikohen”.

KVO veren se bazuar ne nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote”, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën përshprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriteret duhet të jenë në përputhje me LPPnë dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit rezulton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik është pjesëmarrës (ofertues) në Lotin e I-re dhe në Lotin II-te.

Referuar kritereve të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.8 **për disponimin në stafin e tyre teknik, në licencën e shqërisë (Drejtues teknik) ku për secilin lot është kërkuar disponimi i 1 (nje) Ing Ndertimi, 1 (nje) Ing Mjedisi, 1 (nje) Ing Hidroteknik dhe 1 (nje) Ing topograf, si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë të cilët do të paraqesin ofertat/konkurrojnë për më shumë se një lot, duhet të plotesojnë në menyre kumulative të gjithë kriteret e loteve të marra së bashku** në të kundërt do të skualifikohen rezulton se për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në më shumë se një lot për të përmbushur këto kriter duhet të disponojnë të paktën 2 (dy) Ing Ndertimi, 2 (dy) Ing Mjedisi, 2 (dy) Ing Hidroteknik dhe 2 (dy) Ing Topograf.

Ndërkohë nga verifikimi i Formularit përmbledhës të vetedeklarimit rezulton se ky OE ka deklaruar disponimin stafit si drejtues teknik të cilët figurojnë në licencën e shoqërisë të **1 (nje) Ing Ndertimi, 1 (nje) Ing Mjedisi, 1 (nje) Ing Hidroteknik dhe 1 (nje) Ing topograf**, ndërkohë që në respektim të kërkesës së autoritetit kontraktor duhet të ishte deklaruar disponimi i të paktën 2 (dy) Ing Ndertimi, 2 (dy) Ing Mjedisi, 2 (dy) Ing Hidroteknik dhe 2 (dy) Ing Topograf.

Referuar sa më lart, KVO vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në më shumë se një lot që duhet të përmbushin në menyre kumulative të gjithë kriteret e loteve të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohen.

Ndërsa në nenin 42, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”*. Nga ana tjetër, vetë autoriteti kontraktor në lidhje me këtë kriter ka përcaktuar se operatorët ekonomik të cilët ofertojnë në më shumë se sa një Lot, duhet të përmbushin në menyre kumulative të gjithë kriteret e loteve të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohen.

Në rastin konkret, si dhe nga verifikimi i kryer rezulton se operatori ekonomik ka ofertuar në dy lote edhe në lotin I-re edhe në lotin e II-te, rrjedhimisht në lidhje me plotësimin e kriterit për drejtuesit teknik duhet të dispononte shumatorën totale të drejtuesve teknik të kërkuar në të dy lotet të marra së bashku. Në këtë kuptim KVO gjykon se operatori ekonomik është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, sa i takon përmbushjes së kriterit 2.3.4 dhe 2.3.8 sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

KVO thekson, se nga ana e operatorit ekonomik nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që

autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente pasi nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, si dhe nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

KVO thekson, se operatori ekonomik duhet të kishte deklaruar disponomin e stafit Teknik sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit ku është cituar se ***Operatoret Ekonomike pjesemarrës në mënyrë kumulative të gjithë kriteret e loteve të për të cilat ka ofertuar marra se bashku (kriteri 2.3.4 dhe 2.3.8) në të kundërt do të skualifikohen***

Per me teper KVO verën se edhe Komisioni i Prokurimit Publik me ane të vendimit nr. **1017/2025**, ka mbajtur të njëjtin qëndrim ku ndër të tjera citon: **“Në rastin konkret, si dhe nga verifikimi i kryer rezulton, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA ka ofertuar në dy lote, edhe në lotin II edhe në lotin III, rrjedhimisht në lidhje me plotësimin e kriterit për kontratat të ngjashme duhet të plotësojë vlerën e shumatorës së dy loteve së bashku. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është në kushtet e mospërbushjes së kërkesave në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi”.****Për sa kohë që operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është ofertues në dy lote atëherë për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqiste dokumentacion sa shumatorja e të dy loteve, në përputhje me të dhënat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.**

Komisioni i Vleresimit të Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotësimin të kriterëve të vecanta të paraqitura në DST, për të përmbushur njesoj nga të gjithë Operatoret Ekonomik pjesemarrës është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerinë dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik *si lex specialis* mbi lëndën.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të

shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “InfraKonsult” Shpk, me Nuis L21512022F, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “InfraKonsult” Shpk, me Nuis L21512022F, skualifikohet.

VII- Operatori Ekonomik “INFRATECH” Shpk, me Nuis K91628001D,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se: Operatori Ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike nën vlerën minimale të lejuar sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

KVO verën se operatorët ekonomikë duhet të përgatisin ofertën ekonomike në përputhje me VKM-ne nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe vlera e ofertes ekonomike duhet të jetë jo më e vogël se vlera minimale, si dhe jo më e madhe se vlera maksimale e përcaktuar në përputhje me VKM-ne nr. 354, datë 11.05.2016, ku parashikohet se: “*Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik*”.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se Operatori Ekonomik ka paraqitur oferte ekonomike me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar sipas përcaktimeve të VKM-se nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshkrimet e përcaktuara të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “INFRATECH” Shpk, me Nuis K91628001D, për mos përmbushje të kritereve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “INFRATECH” Shpk, me Nuis K91628001D, skualifikohet.

VIII- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “LENI-ING” Shpk, me Nuis J88730334W & “ANGERBA” Shpk, me Nuis L01322018T,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se: BOE nuk plotëson pikën 2.3.4 dhe 2.3.8 të kritereve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se:

-“2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë në stafin e tij, dhe të figurojnë në liçencën e shqërisë (Drejtues teknik) personeli si më poshtë:

<i>q. Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>r. Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>s. Inxhinier Mjedisi</i>	<i>1 (nje)</i>
<i>t. Inxhinier Gjeodet</i>	<i>1 (nje)</i>

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të mbikëqyrjes, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të

shoqërisë për periudhen Nentor 2025 – Janar 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatëse.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit”.

-”2.3.8 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në më shumë se një lot duhet të përmbushin në mënyrë kumulative të gjithë kriteret e lotëve të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohen”.

KVO verën se bazuar në nenin 42 “Kontrata për punë/mall/shërbim të ndarë në lote”, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre lotëve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e lotëve që mund t'i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i lotëve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë lotëve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatohen për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPPnë dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e lotëve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkohen operatorëve, duke iu referuar grupeve të lotëve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi

dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

Sa me sipër KVO pas shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit konstaton, se procedura në fjalë është procedurë e ndarë në lote. Gjithashtu nga verifikimi i loteve të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik është pjesëmarrës (ofertues) në Lotin I-re dhe në Lotin II-te.

Referuar kritereve të veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.8 për **disponimin në stafin e tyre teknik, në licencën e shqërisë (Drejtues teknik)** ku për secilin lot është kërkuar disponimi i të paktën 1 (nje) Ing Ndertimi, 1 (nje) Ing Mjedisi, 1 (nje) Ing Hidroteknik dhe 1 (nje) Ing topograf, **si dhe kërkesës së autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë të cilët do të paraqesin ofertat/konkurrojnë për më shumë se një lot, duhet të plotesojnë në mënyrë kumulative të gjithë kriteret e loteve të marra së bashku** në të kundërt do të skualifikohen rezulton se për operatorët ekonomike pjesëmarrës në më shumë se një lot për të përmbushur këto kritere duhet të disponojnë të paktën 2 (dy) Ing Ndertimi, 2 (dy) Ing Mjedisi, 2 (dy) Ing Hidroteknik dhe 2 (dy) Ing Topograf.

Ndërkohë nga verifikimi i Formularit përbeledhës të vetedeklarimit rezulton se BOE ka deklaruar disponimin e stafit si drejtues teknik të cilët figurojnë në licencat e shoqërive të **1 (nje) Ing Ndertimi (Nikoll Paluca)**, 2 (dy) Ing Mjedisi (Nikoll Marku; Nikoll Gega), **1 (nje) Ing Hidroteknik (Burhan Hafizi) dhe 1 (nje) Ing topograf (Mhill Pacuku)**, ndërkohë që në respektim të kërkesës së autoritetit kontraktor duhet të ishte deklaruar disponimi i të paktën 2 (dy) Ing Ndertimi, 2 (dy) Ing Mjedisi, 2 (dy) Ing Hidroteknik dhe 2 (dy) Ing Topograf.

Referuar sa më lart, KVO vëren, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në më shumë se një lot që duhet të përmbushin në mënyrë kumulative të gjithë kriteret e loteve të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohen.

Ndërsa në nenin 42 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë”*. Nga ana tjetër, në lidhje me këtë kriter Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomik i cili ofertojnë në më shumë se sa një Lot, duhet të përmbushin në mënyrë kumulative të gjithë kriteret e loteve të marra së bashku në të kundërt do të skualifikohen.

Në rastin konkret, si dhe nga verifikimi i kryer rezulton, se operatori ekonomik ka ofertuar në dy lote edhe në lotin I-re edhe në lotin II-te, rrjedhimisht në lidhje me plotësimin e kriterit për drejtuesit teknik duhet të dispononte shumatorën totale të drejtuesve teknik të kërkuar në të dy lotet të marra së bashku. Në këtë kuptim KVO gjykon, se operatori ekonomik është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, sa i takon përmbushjes së kriterit 2.3.4 dhe 2.3.8 për disponimin e stafit teknik sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.

KVO thekson, se nga ana e operatorit ekonomik nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumente pasi nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit, si dhe nuk ka ofertuar sipas përcaktimeve të bëra në dokumentet e tenderit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

KVO thekson, se operatori ekonomik duhet të kishte deklaruar disponimin e stafit Teknik sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit ku është cituar shprehimisht se ***Operatoret Ekonomike pjesëmarrës në mënyrë kumulative të gjithë kriteret e loteve të për të cilat ka ofertuar marra së bashku (kriteri 2.3.4 dhe 2.3.8) në të kundërt do të skualifikohen***

Per me teper KVO verën se edhe Komisioni i Prokurimit Publik me ane të vendimit nr. 1017/2025 ka mbajtur të njëjtin qëndrim ku ndër të tjera citon: **“Në rastin konkret, si dhe nga verifikimi i kryer rezultoi, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA ka ofertuar në dy lote, edhe në lotin II edhe në lotin III, rrjedhimisht në lidhje me plotësimin e kriterit për kontratat të ngjashme duhet të plotësojnë vlerën e shumatorës së dy loteve së bashku. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është në kushtet e mospërmbushjes së kërkesave në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi”**.**Për sa kohë që operatori ekonomik “Kappa Oil” SHA është ofertues në dy lote atëherë për përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqiste dokumentacion sa shumatorja e të dy loteve, në përputhje me të dhënat e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.**

Komisioni i Vleresimit të Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotësimin të kriterëve të veçanta të paraqitura në DST, për të përmbushur njesoj nga të gjithë Operatoret Ekonomik pjesëmarrës është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerinë dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik *si lex specialis* mbi lëndën.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nënien 76, pika 3/a dhe nënien 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose

entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “LENI-ING” Shpk, me Nuis J88730334W & “ANGERBA” Shpk, me Nuis L01322018T, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “LENI-ING” Shpk, me Nuis J88730334W & “ANGERBA” Shpk, me Nuis L01322018T, skualifikohet.

IX- Operatori Ekonomik “Noor Engineering” Shpk, me Nuis M41919024C,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson pikën 2.2.1, të kushteve të vecanta të kualifikimit, ku parashikohet se: *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur vërtetim për xhiro vjetore për vitet financiare 2022 dhe 2023 të kërkuara në DST.

Se dyti, nuk ploteson pikën 2.3.1 të kushteve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës*

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbimet e ngjashmë janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe/ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

KVO thekson se për përmbushjen e këtij kriteri kur shërbimet e ngjashmë janë realizuar me institucione shtetërore, **Operatori ekonomik duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara ne organet tatimore për institucionin shtetëror**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ndërsa, për përmbushjen e këtij kriteri kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur:

1. Fature tatimore me subjektin “TAULANT” SH.P.K për “Sherbim Mbikqyrje Supervizion punimesh “Ndertim rruga BeratBallaban, Loti 2” ku kontraktor me institucionin shtetëror është subjekti “TAULANT” SH.P.K, I cili **nuk ka miratim për nenkontraktim**. KVO thekson se kontratën me objekt: “Sherbim Mbikqyrje Supervizion punimesh “Ndertim rruga BeratBallaban, Loti 2” operatori ekonomik “Noor Engineering” Shpk, me Nuis M41919024C bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE rezulton se nuk ka pasur asnjë autorizim për hyrje në kantierin e ndertimit dhe për rrjedhojë nuk ka qene i autorizuar për kryerjen e shërbimit të mbikqyrjes.

Sa me sipër dokumentacioni i paraqitur për këto shërbime nuk është i saktë pasi nuk ka qene i autorizuar dhe miratuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për kryerjen e shërbimit të mbikqyrjes së punimeve në këto objekte.

KVO mban në konsideratë se në nenin 12.1 të kontratës së lidhur midis ARRSH dhe subjektit “TAULANT” SH.P.K parashikohet se: **“Nenkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës”** dhe për rrjedhojë çdo nenkontraktim është fiktiv dhe nuk mund të merret në konsideratë.

2. Fature tatimore me subjektin “INFRATECH” SH.P.K për “Sherbim Mbikqyrje: Plotesim, Rakordim dhe vazhdim i Reabilitimit të segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja, Loti 3”, ku kontraktor me institucionin shtetëror është subjekti
-

“INFRATECH” SH.P.K, i cili **nuk ka miratim per nenkontraktim**. KVO thekson se kontraten me objekt “Sherbim Mbikqyrje: Plotesim, Rakordim dhe vazhdim i Reahabilitimit te segmentit rrugor Mbikalimi i pallatit me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja, Loti 3” operatori ekonomik “Noor Engineering” Shpk, me Nuis M41919024C bazuar ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE rezulton se nuk ka pasur asnje autorizim apo miratim per hyrje ne kantjerin e ndertimit dhe per rrjedhoje nuk ka qene i autorizuar per kryerjen e sherbimit te mbikqyerjes.

Sa me siper dokumentacioni i paraqitur per kete sherbim nuk eshte i sakte pasi nuk ka qene i autorizuar nga Autoriteti Rrugor Shqipetar per kryerjen e mbikqyerjes se punimeve ne kete objekt.

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 26, te kontrates se lidhur midis ARRSH dhe subjektit “INFRATECH” SH.P.K & "ARKIMADE" SH.P.K parashikohet se: *“Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë*

Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë” dhe per rrjedhoje cdo nenkontraktim eshte fiktiv dhe nuk mund te merret ne konsiderate.

3. Fature tatimore me subjektin “ARKIMADE” SH.P.K per Sherbim i mbikqyrjes “Ndertimi I godines se re te laboratoreve ne ISHP” ku kontraktor me institucionin shteteror eshte subjekti “ARKIMADE” SH.P.K, i cili nuk ka miratim per nenkontraktim. KVO thekson se kontraten me object “Sherbim Mbikqyrje Supervizion punimesh “Sherbim i mbikqyrjes “Ndertimi I godines se re te laboratoreve ne ISHP” operatori ekonomik “Noor Engineering” Shpk, me Nuis M41919024C bazuar ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE rezulton se nuk ka pasur asnje autorizim per hyrje ne kantjerin e ndertimit dhe per rrjedhoje nuk ka qene i autorizuar per kryerjen e sherbimit te mbikqyerjes.

Sa me siper dokumentacioni i paraqitur per kete sherbim nuk eshte i sakte pasi nuk ka qene i autorizuar nga INSTITUTI SHËNDETIT PUBLIK per kryerjen e mbikqyerjes se punimeve ne kete objekt.

KVO mban ne konsiderate se ne neni 12.1 te kontrates se lidhur midis INSTITUTI SHËNDETIT PUBLIK dhe subjektit “ARKIMADE” SH.P.K parashikohet se **“Nënkontraktimi nuk duhet të bëhet pa aprovimin paraprak me shkrim të Blerësit dhe jo më shumë se 50% të vlerës së kontratës”** dhe per rrjedhoje cdo nenkontraktim eshte fiktiv dhe nuk mund te merret ne konsiderate.

KVO mban ne konsiderate se per te gjitha faturat tatimore per sherbime te pretenduara te realizuara si nenkontraktor me institucione shteterore, operatori ekonomik nuk ka qene i **autorizuar dhe miratuar** si nenkontraktor dhe per rrjedhoje cdo nenkontraktim eshte fiktiv dhe nuk mund te merret ne konsiderate.

Ne vijim, KVO verifikoi dokumentacionin e paraqitur ne SPE ku rezultoi se sherbimet e ngjashme per te cilat jane me dokumentacion te vlefshem nuk arrijne vleren prej 40% te vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe per rrjedhoje ky kriter konsiderohet i papermbushur.

